



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU -BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.11/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykates Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës Për inicim të procedurës disiplinore te parashtruar nga ana e ankuesit B.B.; nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të tij av.B.K., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar ne Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.914/14, ne baze te Së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.27.09.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesit B.B.. nga Prizreni, respektivisht të përfaqësuesit të tij av. B.K., nga Prizreni, ndaj gjyqtarit A..B., gjyqtar ne Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës civile C.nr.914/14.

**Arsyetim**

Parashtruesi i ankesës av.B.K., me date 30.08.2024 ka parashtruar kërkesë per inicim te procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar ne Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm -Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës civile C.nr.914/14.

Ankuesi av.B.K., në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se në vitin 2014 është paraqitur lënda C.nr.914/ 14 me paditës B.B., ku pas disa viteve në nëntor të vitit 2019 kane paraqitur fjalët përfundimtare ndërsa edhe sot pas më shume se 5 viteve nuk është dorëzuar vendimi me shkrim. Në vazhdimësi kanë kërkuar dorëzimin e këtij vendimi nga administrata, por e njëjta është përgjigjur që gjyqtari nuk e ka sjellë akoma lëndën nga zyra e tij ne administratë.. Po ashtu, ka shikuar librin e protokollit it dhe kjo lëndë që nga viti 2014 nuk ka dalë nga zyra e gjyqtarit, andaj në atë libër te protokollit nuk shënohet tjetër, përveq regjistrimit të lëndës dhe pranimit të lëndës nga gjyqtari. Këtë punë gjyqtari e ka bërë me qëllim pasi që me njërin prej

të paditurve ishte njohur edhe më herët, kanë qene fqinjë. Kjo është shkelje e detyrave të punës, sidomos kur bëhet me qëllim. Gjyqtari vendimin meritor duhet ta merr ne afat prej 30 ditësh (në raste specifike 60 ditë). Gjyqtari do të tregoj që vendimin e ka nxjerrë me kohë, por kinse administrata nuk e ka dorëzuar, por si mund të dorëzoj administrata vendimin pa e nxjerrë lëndën gjyqtari nga zyra e tij.

Po ashtu, ka deklaruar që ka prova nga libri i protokollit që deri me datë 29.08.2024 lënda nuk është dorëzuar në administratë.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit A.B., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm - Divizioni Civil, lidhur me lëndën C.nr.914/14 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar dosjen fizike të lëndës C.nr.914/14 si dhe ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka deklaruar se pasi që lënda C.nr.914/2014 nuk ndodhet fizikisht ne zyren e tij, e ka pasur të pamundur që të paraqes në detale lëvizjen e kësaj lënde nga dita e pranimit e deri ne përfundimin e saj me aktgjykim. Shënimet në të cilat është bazuar, për fat ekzistojnë në sistemin SMIL. Nga të dhënat që janë në sistemin SMIL vërtetohet që seancën e parë në këtë lëndë e ka caktuar me datë 19.03.2019, janë mbajtur disa seanca. Ndërsa me datë 31.12.2019 ne sistem ka publikuar aktgjykimin. Në seancën fundit të mbajtur me datë 06.11.2019, palët kanë kerkuar që fjalën përmbyllese ta dorëzojnë me shkrim, me aktvendim ia ka dhënë 7 ditë afat, pasi që palët kanë dorëzuar fjalën përmbyllese, ia ka dorezuar palëve kundërshtare, pas këtij veprimi lëndën për draftim ia ka dorëzuar bashkëpunëtorit, ku pas draftimit nga e ana bashkëpunëtorit dhe pasi që vet ka analizuar në tëri aktgjykimin, me datë 31.12.2019 aktgjykimin e ka ngarkuar në sistemin SMIL. Në momentin që gjyqtari e kryen aktgjykimin, ne rastin e tij, aktgjykimin e kryer e ka ngarkuar në sistemin SMIL, urdhërohet, në atë kohë daktilografja që lëndën e kompletuar ta dorezoj në administratë. Pra, nga ky moment gjyqtari nuk ka të bëjë asgjë me lëndën deri sa të paraqiten ankesat apo lënda te arkivohet. Tutje deklaroi se, çfarë është bërë me atë lëndë fare nuk ka ide. Detyra e tij ka qenë përpilimi i aktgjykimit dhe ngarkimi i tij në sistemin SMIL. Fletorja e dorëzimeve për vitin 2019 ka qenë e plotësuar, nuk ka pasur hapësirë për lëndët tjera që ka dorëzuar dhe mbi këte bazë ka ndërruar fletore. Atë fletore tani për tani nuk mund ta giejë. Shënimet e fundit që i ka të ruajtura janë nga muaji Shkurt i vitit 2020, në fletoren tjetër. Duke pasur parasysh që nga viti 2019 e deri më tani kanë kaluar 5 vite, nuk ka mundur te parashikoj që për aq kohë palët nuk e marrin aktgjykimin me qëllim që të ruaj shënime për kohën e dorëzimit të lëndës në administratë. Në anën tjetër dorëzimi i lëndës në administratë, ne atë kohë ishte bërë nga daktilografja. Daktilografia lëndën e ka dorëzuar në administratë. Ne atë kohë ekspedimi është bërë nga zyra e administratës e jo nga zyra e gjyqtarit siç bëhet tani. Gjithashtu, sistemi SMIL ka filluar punën pikërisht në vitin 2019, ka pasur shumë paqartësi, se kush të ekspedon vendimet. Një kohë e cila ka zgjatur deri në tremujorin e parë të vitit 2020, vendimet përmes formularëve të veçantë dhe të mbyllura nëpër pliko janë ekspeduar nga zyra e dorëzimeve. Krejt kjo me qëllim që mos të shikohet mënyra e vendosjes pasi që kishte informacione që dorëzuesit paraprakisht i njoftonin palët me mënyrën e vendosjes. Asnjëherë, si në atë kohë e edhe tani nuk ndodhë që posa të dorëzohet lënda poshtë, menjehere e njëjta të konstatohet në regjistrat që mban gjykata. Ato regjistra fillojnë të plotësohen në rastin kur kompletohet lënda për gjykatën e shkallës tjetër sipas mjetit juridik e në disa raste kur lënda

arkivohet. Përveç, përpilimit të aktgjykimit, nuk është detyrë e gjyqtarit si ekspedimi i lëndës e po ashtu edhe dorëzimi në administratë. Ne kohën për të cilën bëhet fjalë, referati civil në administratë ka qenë në gjendje të mjerueshme, mbi 4 referent brenda një periudhe të shkurtër janë ndërruar në atë referat. Gjithashtu, për çdo 31 Dhjetor nga ana e gjykatës organizohet kokteli për ndërrimin e viteve. Lënda ka mundur të lihet për tu punuar pak më vonë dhe që aty ka filluar problemi me lëndën e cila tani konsiderohet se nuk ekziston. Po ashtu, ka deklaruar se jo vetëm tani që ka shikuar 3 herë por edhe gjatë kohëve të fundit kur ka bërë deklarinimin e numrit të lëndëve që kanë kërkuar nga çdo gjyqtar, asnjëherë ajo lëndë nuk ka qenë fizikisht në zyrën e tij. Gjithashtu, edhe dy zyrtaret që i k urdhëruar Kryetarja për ta shikuar lëndën, pasi që kanë shikuar në hollësi të gjithë zyrën, lënda nuk është gjetur në zyrë. Është për tu quditur pavarësisht se pala thekson se disa here ka kërkuar aktgjykimin, përse deri me tani gjyqtari i çështjes nuk është informuar? Aq më tepër kur edhe aktgjykimi ka qenë i ngarkuar në sistemin SMIL?! Përveç që aktgjykimi ka qenë i ngarkuar në SMIL, në sistemin SMIL është paraqitur çdo veprim procedural që ka ndërmarrë në atë lëndë, që i bie se ka pasur transparencë të plotë sa i përket procedimit të asaj lënde. Gjithashtu, lënda ka filluar të punohet nga muaji mars i vitit 2019 dhe është përfunduar me vendim meritore në muajin dhjetor të po atij viti, përkatesisht brenda 9 muajve, gjatë asaj kohe ka gjykuar edhe shumë lëndë tjera. Pretendimi i avokatit ka qenë që ka kryer shkelje të rënda pasi që pala nuk e ka pranuar aktgjykimin që nga "muaji nëntor 2019, kur vendimi meritore duhet merret në afat prej 30 ditësh (eventualisht 60 ditësh)". Në rastin konkretë vendimin meritore e ka marrë dhe një kohësisht e ka ngarkuar në sistemin SMIL, brenda afateve ligjore. Se çfarë është bërë më tej me at lëndë, nuk e ka idenë. Andaj, propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari i çështjes, gjithashtu ka kërkuar informate edhe nga Shefe e Zyrës së Menaxhimit të Lëndëve lidhur me dorëzimin e lëndës në shkrimore, shënimet nga regjistri, shënimet nga libri për ekspedim, informata nga arkiva dhe shënimet tjera të rëndësishme për vërtetim të gjendjes faktike lidhur me këtë lëndë dhe nga e njëjta ka pranuar përgjigjen se në Gjykatën Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm—Civil, me datë 27.01.2014, është regjistruar lënda me numër, C.nr.914/2014, si Padi për kompensimin e demit ku si Padi është B.B., dhe të paditur janë Zh.S., A.V., Sh.A., dhe I.T., Pas regjistrimit lënda i është dërguar gjykatësit A.B.,. Gjatë shikimit të regjistrimit është vërtetuar se të gjitha kolonat janë të paplotësuara, për shembull, data e vendosjes, data e ekspeditimit, data e plotfuqishmërisë si dhe data e arkivimit. Me datë 19.03.2019 lënda është regjistruar edhe në programin e SMIL-2019:080340, ku evidentohen edhe veprimet lidhur me këtë lëndë. Në Sistemin e SMIL në gjykatë me datë 31.12.2019 me numrin e lëndës, C.nr.914/2014 i datës 06.11.2019, është ngarkuar aktgjykimi numri i SMIL-2019:080339 numri i dokumentit 00743963 .Në Gjykatën Themelore në Prizren, në të gjitha departamentet ka ekzistuar rregull që lëndët që u janë ndarë gjyqtarëve nga shkrimorja civile, tu dorëzohen me fletore ku janë edhe nënshkrimet për pranimit dorëzim edhe gjatë dorëzimit të lëndëve të kryera dorëzimin e bën zyrtarja ligjore e gjyqtarit dhe pranimit e nënshkruan referenti i shkrimores përkatëse, në këtë rast referenti i divizionit civil. Këtë rregull nuk mundë ta vërtetojmë, sepse gjyqtari A.B., nuk e posedon fletoren e dorëzimit të kësaj lënde si të muajit dhjetor 2019 po ashtu edhe të muajit Janar 2020. Nuk mundë ta vërtetojmë se lënda me numër, C.nr.914/2014 është dorëzuar si e kryer dhe arkivuar në shkrimoren e Gj.TH.në Prizren. Kemi kërkuar edhe në zyrën e gjyqtari të lëndës së lartcekur por lënda nuk është gjetur.

Gjithashtu me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike si Autoritet kompetent kam kërkuar informatë nga avokatët tjerë në këtë çështje avokati D.N., dhe A.J., të cilët kanë deklaruar se nuk e kanë pranuar aktgjykimin sipas lëndës C.nr.914/2014.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Sipas të dhënave që figurojnë në sistemin SMIL rezulton se, ne Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me datë 27.10.2014 është parashtruar padia e paditësit B.B., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.B.K., nga Prizreni kundër të paditurve Zh.S., nga fshati Bogoshevac, Komuna e Prizrenit, A.V., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av.A.J., nga Prizreni, I.T., nga fshati Gërinqare, Komuna e Prizrenit të cilin me autorizim e përfaqëson av.D.N., nga Prizreni dhe Sh.A., nga Prizreni, me Objekt të kontestit kompensim dëmi, e Cila është e evidentuar si C.nr.914/14. Me këtë lëndë është ngarkuar gjyqtari A.B., Gjyqtari në këtë çështje ka caktuar dhe ka mbajtur disa seanca, ku në SMIL janë të evidentuara seancat e caktuara prej datës 19.03.2019 e tutje. Gjykata lidhur me këtë çështje me datë 06.11.2019 ka mbajtur seancën e fundit ku palët kanë parashtruar fjalët e tyre përfundimtare. Pas kësaj, gjyqtari i çështjes me datë 31.12.2019 ka ngarkuar aktgjykimin C.nr.914/14 ne sistemin SMIL.

Pas pranimit të ankesës së av.B.K., Kryetarja nëpërmjet email-it zyrat fillimisht ka kërkuar lëndën nga gjyqtari i çështjes, i cili ka deklaruar se dosja fizike e lëndës nuk është ne zyrën e tij. Pas kësaj, Kryetarja edhe në komunikim verbal ka kërkuar që gjyqtari të kontrollojë edhe një herë zyrën e tij. Po ashtu, me urdhër të Kryetares janë angazhuar edhe dy zyrtare Për të kërkuar lëndën në fjalë në zyrën e gjyqtarit si dhe është urdhëruar edhe arkivisti i gjykatës që të kërkojë lëndën ne arkiv, por edhe pas kërkimeve të të njëjtit nuk ka mundur të gjendet lënda. Është bërë shikimi i librit te regjistrit të lëndëve, ku rezulton se te e njëjta nuk ekziston asnjë shënim lidhur me ecurinë e kësaj lënde. Po ashtu, Kryetarja e gjykatës me shënim zyrtar i është drejtuar Shefes se Zyrës se Menaxhimit të Lëndëve lidhur me dorëzimin e lëndës në shkrimore, shënimet nga regjistri, shënimet nga libri Për ekspedim, informata nga arkiva dhe shënimet tjera të rëndësishme Për vërtetim të gjendjes faktike lidhur me këtë lëndë ku ka pranuar informatë se kjo lëndë sipas shënimeve në Librin e regjistrave figuron se është tek gjyqtari A.B.,.

Nga analiza e të gjitha provave dhe shënimeve lidhur me lëndën civile C.nr.914/14 është vërtetuar se kjo lëndë nuk është në zyrën e gjykatësit , nuk është në shkrimore dhe as në arkiv Lënda fizikisht nuk gjindet . Nga shënimet e sistemit SMIL është vërtetuar se gjyqtari A.B., pas pranimit të lëndës ka caktuar disa seanca dhe seanca përfundimtare është mbajtur me dt. 06.11.2019 dhe Aktgjykimi është ngarkuar ne sistem me dt. 31.12.2019. Shënime tjera nuk ka. Është evidente se lënda C.nr.914/2014 nuk është ekspeduar dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt në shkrimore . Sipas rregullit me rastin e përfundimit të lëndës gjyqtari është i obliguar që të merr vendim përfundimtar dhe të ngarkon në sistemin SMIL dhe që lëndën fizike me fletore nëpërmjet zyrtares ligjore të dorëzojë në zyrën e shkrimore. Kjo detyrë i ka takuar zyrtares ligjore e Cila ka punuar me gjyqtarin A.B., dhe e Cila në vitin 2021 është pensionuar. Gjyqtari detyrat


e veta të punës i ka zbatuar dhe me vet faktin se e ka ngarkuar cendimin përfundimtar me kohë dhe në afat ligjor , kjo lëndë në sistem SMIL figuron e zgjidhur nga data e ngarkimit. Gjithashtu sipas kërkesës së Kryetares me rastin e ri organizmit dhe barazimit të lëndëve gjyqtari A.B., ka dorëzuar listën e lëndëve të cilat i ka në punë fizikisht në zyre dhe në këtë liste nuk figuron lënda kontestuese , në bazë të se cilës konstatojmë se e njëjta nuk ka qenë tek gjyqtari që nga momenti kur e ka ngarkuar dhe sipas tij ka qenë e përfunduar.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideron se gjyqtari A.B., në veprimet e tij nuk ka pasur Shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore te parapara me Ligjin Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë Shkelje sa i përket sjelljes, qoftë kur është ne detyrë apo privatisht, te cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit. Gjyqtari i ka zbatuar detyrat e veta të punës dhe nuk mund të jetë përgjegjës për veprimet e administratës , konkretisht të zyrtares ligjore e cila ka pasur për detyrë dhe obligim që të ekspedojë dhe të dorëzojë lëndën ne shkrimore .

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 Për përgjegjësinë disiplinore te Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE Në PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.11/2024, me dt.27.09.2024**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.